



FORÇA JONË

* * * Viti III • Nr. 31 • Dhjetor 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Të gatshëm për mision të ri!

Ky vit është vit i progresit të konsiderueshëm dhe edicioni special "Forca Jonë" tregon sa shumë kemi arritur së bashku. Ne jemi krenarë për atë se çfarë kemi bërë dhe jemi të gatshëm për të gjitha sfidat e së ardhmes në rrugën drejtë zhvillimit të mëtutjeshëm.

Dëshiroj të shpreh falënderimin tim të sinqertë të gjithë pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), të cilët kanë punuar me shumë zell për ta zhvilluar dhe fuqizuar Forcën tonë. Puna e juaj me përkushtim vlerësohet lart nga komandantët e juaj dhe nga qytetarët e vendit tonë. Siç e dini, këtë pranverë Qeveria e ka përmbyllur Rishikimin e Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Konkluzioni nga ky rishikim është që FSK-ja të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës



dhe që Kosova gradualisht duhet të marrë përgjegjësi të plota për sigurinë e saj.

Jam plotësisht i bindur që FSK-ja është gati të marrë këtë mision të ri. FSK-ja është gati të bëhet forcë e cila i mbron interesat e sigurisë së Kosovës dhe kontribuon në sig-

urinë regjionale, evropiane dhe ndërkombëtare. Kjo është detyrë shumë fisnike dhe jemi plotësisht të vetëdijshëm që do të kërkojë nga secili prej nesh shumë përkushtim, kujdes dhe besnikëri. Ëndrra dhe dëshira jonë më e madhe është të bëhemi pjesë e familjes Euro-Atlantike.

Ne dëshirojmë ta zëmë vendin tonë në Institucionet Euro-Atlantike dhe të kontribuojmë për një botë më të mirë ku secili ndihet i sigurt. Ne e ndajmë vizionin e NATO-s për Evropën, vendet dhe popujt e të cilëve janë në paqe me njëri-tjetrin dhe me fqinjët e tyre. Ky është synimi ynë strategjik dhe së bashku do ta bëjmë maksimumin tonë që ta arrijmë atë.

Agim Çeku,
Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës



FSK-ja shënoi Ditën e Forcës me ceremoni ushtarake

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, me një manifestim solemn të mbajtur në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, shënoi Ditën e Forcës, ditën e themelimit të saj dhe përuroi ndërtesën e re të

Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ceremonia për shënimin e Ditës së Forcës filloi me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të FSK-së nga presidentja Atifete Jahjaga dhe gjeneralljtënant Kadri Kastrati.

Thellohet bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Agim Çeku, së bashku me komandantin e FSK-së gjeneralljtënant Kadri Kastratin dhe sekretarin e përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj, me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë, më 6-7 nëntor qëndruan për një vizitë zyrtare në Republikën e Letonisë. Delegacioni i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës u prit në Riga nga ministri i Mbrojtjes së Letonisë, z. Raimonds Vejonis dhe stafi i lartë i kësaj ministrie. Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes të Letonisë kanë marrëveshje bashkëpunimi, dhe kjo vizitë po zhvillohet me qëllim të thellimit të këtij bashkëpunimi. Ministri i Letonisë i konfirmoi

ministrit Çeku gatishmërinë e tij për mbështetjen në zhvillimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe vazhdimin e bashkëpunimit dypalësh në mes dy ministrive. Ministri i FSK-së, Agim Çeku, me këtë rast, falënderoi ministrin e Mbrojtjes si dhe Qeverinë e Letonisë për mbështetjen e pakursyer për zhvillimin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, që është thelbësore për Kosovën. Ministri i Mbrojtjes së Letonisë, z. Raimonds Vejonis, gjatë takimit, i premtoi ministrit Çeku ndihmën dhe mbështetjen e tij për FSK-në dhe Kosovën në integrimet evropiane dhe euro-atlantike. "Letonia i mbështet aspiratat euro-atlantike të Kosovës dhe është e gatshme të ndajë me të përvojën e saj në lidhje me procesin e integritit



në NATO. Unë jam shumë i kënaqur me bashkëpunim e mirë në mes të Letonisë dhe MFSK-së. Letonia është gjithashtu e gatshme ta ndihmoi Kosovën në zhvillimin e forcave të saj të armatosura në të

ardhmen". Ndërsa, ministri i MFSK-së, z. Agim Çeku, u shpreh falënderues për ndihmën e Letonisë. Unë jam shumë mirënjohës për ndihmën e vazhdueshme të Letonisë për Kosovën, aq më tepër jam

mirënjohës dhe e vlerësoj faktin se Letonia është njëra ndër vendet e para që ka njohur pavarësinë e Kosovës. Ne i jemi mirënjohës edhe Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë e cila ka kontribuar dhe po vazhdon të kontribuojë me angazhimin e ekspertëve të saj profesional në Ekipin Këshillues të NATO-s. Ministri Çeku e informoi homologun e tij edhe për planet e Kosovës, për ngritjen e forcave të saj të armatosura, dhe theksoi se Kosova dëshiron t'i bëjë këto zhvillime me mbështetjen e NATO-s. Delegacioni i MFSK-së, më pas, vazhdoi vizitën e tij në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kombëtare të Letonisë dhe në Bazën Ushtarake në Adazhi.



MFSK-ja në Ditën e Forcës përuroi objektin e ri

Në pjesën e dytë të programit për shënimin e Ditës së Forcës, me ceremoni ushtarake u bë përurimi i objektit të ri të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Në fjalën e tij, ministri Çeku përshëndeti presidentin, kryeministrin, ambasadorët, gjeneralët, oficerët dhe nënoficerët, si dhe të gjithë të pranishmit në përuimin e objektit të ri, si dhe Ministrinë e Administratës Publike e cila ka qenë përgjegjëse për realizimin e projektit dhe menaxhimin e punëve të ndërtimit. Ministri Çeku, me këtë rast, tha: "Sot po e shëno-

jmë një ngjarje shumë të rëndësishme e cila është e veçantë për gjithë ne. Jemi të gëzuar pasi që kemi punuar më shumë se 15 vite, në kushte jo edhe aq të volitshme, ndërsa tani na janë ofruar kushte të shkëlqyeshme për punë, hapësira të mjaftueshme dhe moderne. Duke ju drejtuar kolegëve të punës, ministri Çeku tha: "Të nderuar kolegë, jam i sigurt që ju do të ndiheni mirë duke punuar në këtë ndërtesë. Për më shumë, duke pasur një ndërtesë moderne, ju do të keni më shumë mundësi të përqendroni më lehtë

në detyrat e juaja dhe do t'i kryeni ato me ma shumë sukses. Ndërsa, në emër të Ministrisë së Administratës Publike foli zëvendës ministri Fadil Kryeziu, i cili me këtë rast, tha: Ky objekt i MFSK-së i plotëson të gjitha kriteret dhe standardet sipas kërkesave të NATO-s. Objekti ka një sipërfaqe prej 100.00 metrave katrorë dhe ka kushtuar mbi 5.700.000 euro buxhetit të shtetit. Në fund, shiritin e përuimit të objektit e prentë ministri Agim Çeku dhe zëvendës ministri Fadil Kryeziu.

Fjala e KOMFSK-së me rastin e Ditës së Forcës

FSK-ja e gatshme për detyra të reja

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) po e feston përvjetorin e saj të gjashtë. Kjo ditë, tashmë tradicionale, na bashkon të gjithëve për të festuar dhe reflektuar njëkohësisht.

Forca jonë në themelet e saj ka të skali-tur lavdinë dhe përvojën e trashëguar brez pas brezi. FSK-ja si forcë profesionale, shumetnike dhe e motivuar, është institucioni më i besueshëm i vendit. Ky fakt na gëzon e na bënë krenarë, e njëkohësisht na obligon edhe më tepër për të punuar fortë në ruajtjen e imazhit dhe besueshmërisë.

Sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat kemi kaluar dhe ato që na presin, janë sprova që do të kalojnë falë vullnetit dhe përkushtimit tonë të fortë.

Forca jonë përbëhet nga pjesëtarë të motivuar, të përkushtuar e të brumosur me vlerat më të larta. Përkushtimi, gatishmëria, guximi, profesionalizmi, vlerat dhe vlerat më sublimë të mishëruara tek pjesëtarët tonë, na bëjnë tu gëzohemi arritjeve të dëritishme dhe na japin fuqi e besim për ti kaluar edhe sfidat e së ardhmes.

Kjo ditë e veçantë është një moment shumë i përshtatshëm për të shprehur mirënjohjen më të sinqertë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, të cilët po bartin në supet e tyre peshën e ngritjes dhe zhvillimit të FSK-së në një Forcë moderne dhe profesionale. Pjesëtarët e FSK-së, gjithmonë, janë të gatshëm për ti kryer detyrat. Nënoficerët e përgatitur dhe të motivuar, për të qenë gjithnjë krahë për krahë me ushtarët dhe oficerët që udhëheqin me shembullin personal, janë boshti dhe imazhi i Forcës tonë me të cilën të gjithë krenohemi sot.

Arritjet e FSK-së janë të prekshme, kualitative dhe gjithësi të pritura. FSK-ja gjatë gjithë këtyre viteve ka ngritur kapacitete operacionale për realizimin e misionit të sajë në bazë të mandatit kushtetues. Ka ngritur standarde të realizimit të detyrave, duke shfaqur gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së detyrave. FSK-ja vazhdon të kryejë operacione dhe intervenime të rëndësishme qenësore për qytetarët e vendit, siç janë: operacionet e deminimit, operacionet e kërkim-shpëtimit në ujëra, male dhe zona urbane; reagimi i shpejtë i bashkërenduar me institucionet tjera në rast të krizave; angazhimi në shumë projekte humanitare në përkrahje të qytetarëve, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, si dhe komuniteteve anë e kënd Kosovës; asistencë mjekësore në përkrahje të banorëve nga radhët e komuniteteve nëpër zonat e thella.

FSK-ja është në proces të vazhdueshëm të ndërtimit të kapaciteteve, duke e themeluar Task Forcën e Kërkim-Shpëtimit dhe duke i plotësuar kriteret e vendosura për tu certifikuar nga Grupi Këshillues i Kërkim-Shpëtimit Ndërkombëtar, gjë që



shënon bashkëpunimin e suksesshëm në mes nesh dhe partnerëve tanë.

Këtë vit, FSK-ja ka marrë pjesë në një varg ushtrime fushore dhe kurse trajnuese, të cilat synojnë thëllimin e bashkëpunimit në mes shteteve të rajonit gjatë reagimit në kriza dhe situata të menaxhimit të krizave. Pjesëtarët e FSK-së kanë dëshmuar që FSK-ja është forcë për të mirë dhe e aftë, gjithmonë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe e gatshme të

kontribuojë në sigurinë rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare. Në zhvillimin tonë të mëtejshëm, ne bashkëpunojmë ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë të cilëve ju jemi mirënjohës për mbështetjen e tyre, këshillat dhe ekspertizën. Ne e falënderojmë NATO-n për mbështetjen e vazhdueshme përmes NLAT-it dhe NAT-it.

Ndihemi të bekuar dhe krenarë për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe partneritetin me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Si komandant i FSK-së, me siguri të plotë, ritheksoj që FSK-ja është e gatshme të transformohet në Forcë të Armatosura të Kosovës dhe të marrë DETYRAT E REJA - mbrojtjen e vendit dhe qytetarëve të saj. Kjo është një detyrë shumë fisnike dhe jemi plotësisht të përkushtuar ndaj saj. Në këtë ditë të rëndësishme dua që solemnisht të ua uroj Ditën e Forcës, të gjithë efektivave të FSK-së, të gjithë ushtarëve aktiv dhe rezervë, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës uron komandantin e FSK-së për Ditën e Forcës

Gjenerallejtnant Kadri Kastrati
Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës
I nderuari Gjeneral Kastrati
Me mburrje të madhe dëshiroj të ju shkruaj urimet për ju dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës për kremtimin vjetor të Ditës së Forcës të Kosovës.



Qëllimi i një dite që njihet dhe nderon Forcën e Sigurisë së Kosovës është një ngjarje e rëndësishme që simbolizon një hap të rëndësishëm në suksesin e vazhdueshëm të Forcës tuaj të Sigurisë.

Programi ynë i Partneritetit me Forcën e Sigurisë së Kosovës të Republikës së Kosovës është një nga marrëdhëniet tona më të rëndësishme dhe më të qëndrueshme.

Jemi krenar që mbështesim Kosovën dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës si partner i saj.

Vazhdojmë të fuqizojmë partneritetin tonë përmes mundësive të shkëmbimit në Ajova dhe po ashtu në Kosovë.

Ju dhe të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të jeni shumë krenarë me këtë.

Sërish, urimet e mia më të mira dhe të sinqerta në këtë ditë të rëndësishme.

Jam i sigurt që Forca e Sigurisë së Kosovës do të vazhdojë të jetë një forcë për të mirën e të gjithëve në Kosovë, me një prezencë të qëndrueshme në regjionin e Ballkanit.

Mezi presim të vazhdojmë me shumë angazhime në të ardhmen, ashtu siç do të vazhdojmë ta fuqizojmë miqësinë tonë.

Kjo me të vërtetë është diçka për të cilën duhet të jemi krenar.

Sinqerisht,
Timothy E. Orr
Gjeneralmajor, Garda Kombëtare e Ajovës

Shefi i Shtabit të Përgjithsëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë uron Komandantin e FSK-së për Ditën e Forcës

I nderuari Gjeneral Kastrati!

Me rastin e krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës është kënaqësi dhe privilegj që në emrin tim personal por edhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, t'ju përcjell urimet më të sinqerta e të përzemërta.

Forca e Sigurisë së Kosovës, me shërbimin e saj ndaj qytetarëve të Republikës së

Kosovës, ka arritur të krijojë besim dhe krenari brenda vendit, ndërkohë gëzon mbështetje ndërkombëtare gjithnjë e në rritje. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë e vlerësojnë jashtëzakonisht shumë rolin dhe kontributin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në drejtim të forcimit të stabilitetit në rajon. FARSH do të vijojë mbështetjen për FSK për integrim sa më të shpejtë në struktura ushtarake të sigurisë, si dhe do të forcojë bashkëpunimin dypalësh në fusha të ndryshme ushtarake. Duke ju shprehur konsideratat e mia më të larta, më lejoni që edhe njëherë, t'ju përcjell urimet e mia më të mira për ditën e krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.



Gjeneral Major Jeronim Bazo
Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kroate uron Gjeneral Kastratin për Ditën e Forcës

I nderuar Gjeneral Kastrati,
Më lejoni të ofroj urimet më të përzemërta të burrave dhe grave të Forcave të Armatosura Kroate dhe të miat për ty personalisht dhe pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Republikës së Kosovës me rastin e Ditës së Forcës së Sigurisë. Do të dëshiroja të nxjerr në pah faktin që marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Forcave tona të Armatosura janë duke u zhvilluar shumë me sukses. Shpresoj që në drejtim të punës tone të ardhshme, ne do të vazhdojmë të zhvillojmë dhe thellojmë tiparet dhe opsionet e ndryshme të bashkëpunimit ushtarak dypalësh duke i'u përgjigjur parimeve të profesionalizmit dhe partneritetit, në kontributin e përbashkët të ruajtjes së paqës, sigurisë dhe stabilitetit në rajonin tonë. I nderuar Gjeneral, edhe njëherë, pranoni përgëzimet e mia të sinqerta për Ditën e Forcës të Sigurisë. Ju dëshiroj shëndet të mirë dhe sukses si në jetën personale ashtu edhe profesionale për ju, gjithashtu edhe për të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Republikës së Kosovës.



Sinqerisht,
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kroate Gjeneral
Drago Lovric, Ph.D.

Gjeneralmajor Rrahman Rama në ceremoninë e ndërrimit të Komandës së Ushtrisë së SHBA-ve për Evropë

Zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneralmajor Rrahman Rama i shoqëruar edhe nga major Beton Retkoceri dhe rreshter major Fetah Zejnullahu, më 06 nëntor 2014, mori pjesë në ceremoninë e organizuar të ndërrimit të Komandës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara për Evropë (USAREUR) të mbajtur në Wiesbaden të Gjermanisë. Këtë detyrë, deri më tani e ka kryer gjenerallejtënant Donald M. Campbell, ndërsa në vend të tij, detyrën e komandës së USAREUR do ta kryejë gjenerallejtënant Frederick B. Hodges.



Gjeneralmajor Rrahman Rama, me këtë rast, i uroi gjenerallejtënant Frederick Hodges detyrën e re dhe njehëresh e

falënderoi USAREUR-in për ndihmën që ata po japin në vazhdimësi për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Instrukturë të Gardës Kombëtare të Ajovës mbajtën seminarin "Menaxhimi i ciklit jetësor dhe funksionimi i bordeve"



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), nga data 17 deri më 21 nëntor 2014, u mbajt seminarin "Menaxhimi i ciklit jetësor dhe funksionimi i bordeve", nga instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës të udhëhequr nga rreshter majori David Carstens. Qëllimi i seminarit ishte bashkërendimi i veprimëve për përmirësimin e menaxhimit të

karrierës dhe ngritjen e autoritetit dhe ndikimin e nënoficerëve në përgjithësi. Seminarin e ndoqën 35 nënoficerë të FSK-së, me një përbërje të kombinuar nga stafi dhe komanda. Pjesëmarrësit gjatë seminarit i vizitoi edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili falënderoi ekipin e instruktorëve të Gardës Kombëtare të Ajovës për kontributin e dhënë në avancimin dhe

ngritjen profesionale të FSK-së. Ai gjithashtu u shpreh i gatshëm për t'i përkrahur rekomandimet e këtij seminarit dhe projektet tjera të ardhshme. Gjeneral Kastrati me këtë rast ndau mirënjohje për instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës. Rreshter majori i Gardës Kombëtare të Ajovës, David Carstens, në fjalën e tij përmbyllëse, foli për rëndësinë e këtij seminarit dhe për përkushtimin e Gardës Kombëtare të Ajovës për të përkrahur FSK-në në ngritjen profesionale të saj për t'i qar proceset përpara. Ekipin e instruktorëve nga Ajova, për punën e tyre vetëmohuese, e falënderoi Rreshter majori i Komandës së FSK-së Genc Metaj, i cili i përgëzoi edhe pjesëtarët e FSK-së për përkushtimin e tyre dhe pjesëmarrjen aktive në punimet e seminarit "Menaxhimi i ciklit jetësor dhe funksionimi i bordeve".

Bashkëpunim i ngushtë në fushën e mjekësisë ndërmjet MFSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë

Kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, shef i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i shoqëruar nga nënkolonel Bekim Osmani, atashë ushtarak i Kosovës, pranë Ambasadës së Republikës së Kosovës në Ankara dhe major dr. Genc Shala, zëvendëskomandant i Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së, nga data 3 deri me 5 nëntor 2014, qëndruan për vizitë zyrtare në Akademinë ushtarake mjekësore "GATA" në Ankara të Republikës së Turqisë. Kolonel dr. Tahiraj dhe oficerët e lartë të FSK-së u pritën nga dekani i Akademië ushtarake mjekësore, kundëradmirali Hayati Bilgiç. Gjatë takimit të përbashkët u diskutuan çështje të bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ndërmjet dy institucioneve, si dhe thellimi dhe vazhdimi i këtij bashkëpunimit edhe në të ardhmen.



Kundëradmirali Bilgiç premtoi angazhim në drejtim të implementimit të protokollit të bashkëpunimit ndërmjet të dyja institucioneve tona. Gjatë qëndrimit në Ankara, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj me bashkëpunëtorë vizituan edhe Fakultetin e Mjekësisë, Akademinë e Nënoficerëve Mjekësorë, Akademinë e Infermierisë si dhe Qendrën e Rehabilitimit. Gjithashtu oficerët e FSK-së vizitu-

an edhe nënoficerin e FSK-së (A.M), i cili po trajtohet në këtë qendër. Vizita e kolonel dr. Tahiraj, shef i Departamentit Mjekësor në Ministrinë e FSK-së në Akademinë ushtarake mjekësore "GATA" të Republikës së Turqisë, u zhvillua në kuadër të protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë i nënshkruar në prill të këtij viti.

Zëvendësambasadorja e Mbretërisë së Bashkuar vizitoi FSK-në

Ditë më parë, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe në FSK, për një vizitë zyrtare ishte zëvendës ambasadorja e Mbretërisë së Bashkuar, znj. Louise Taylor me bashkëpunëtorë. Zëvendës ambasadorja Taylor e priti ministri i MFSK-së z. Agim Çeku, i cili e falënderoi për ndihmën e vazhdueshme që Mbretëria e Bashkuar po jep për FSK-në, si dhe e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-

së. Po ashtu edhe znj. Louise Taylor e falënderoi ministrin Çeku për pritjen dhe njehëresh premtori vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Më pas ajo vizitoi edhe Qendrën për Studime Universitare (QSU) të FSK-së, ku për shkollimin dhe të arriturat e përgjithshme të kësaj qendre e njoftoi kapiteni Avni Kiqina, komandant i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së.



Gjeneral Kastrati priti një delegacion të mjekësisë ushtarake nga Mbretëria e Bashkuar

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, priti nënkolonel Mike Connolly nga Qendra e Zhvillimit të Koncepteve dhe Doktrinae të Mbretërisë së Bashkuar me bashkëpunëtorë. Nënkoloneli Mike Connolly e njoftoi komandantin e FSK-së, gjeneral Kastratin, për punën e deritanishme të përbashkët me Departamentin e Mjekësisë të FSK-së, në hartimin e dokumenteve dhe doktrinae ushtarake mjekësore. Komandanti i FSK-së e falënderoi nënkolonel Cannolly për bashkëpunimin me Departamentin e Mjekësisë të FSK-së, për angazhimin dhe punën e palodhshme që ata po bëjnë në hartimin e doktrinae ushtarake për mjekësi. Në takim mori pjesë edhe drejtori i Departamenti të Mjekësisë të MFSK-së, kolonel Xhevdet Tahiri dhe këshilltari i komandantit të FSK-së, nënkolonel David Jons.



Komandanti i BRSH-së vizitoi Muzeun Arkeologjik në Istog

Komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Nazmi Brahimaj me bashkëpunëtorë, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, më 5 tetor 2014, vizituan Muzeun Arkeologjik të Komunës së Istogut. Delegacionin e BRSH-së e priti z. Enver Boletini, përgjegjës për trashëgimi kulturo-historike në Komunën e Istogut, i cili me këtë rast e njoftoi komandantin e BRSH-së për historikun e muzeut, artefaktet që ka ky muze të cilat pasqyrojnë lashtësinë e trevës së Podgurit. Në muze janë të ekspozuara monumente dhe artefakte të periudhave të ndryshme që nga lashtësia e deri në periudhat e vonshme të historisë së Kombit tonë e që përbëjnë vlera të trashëgimisë së Podgurit: Etnologji, arkeologji të karakterit fetar, kulla, mullinj me ujë, trashëgimi natyrore etj. Gjeneral Brahimaj falënderoi zyrtarët e Muzeut Arkeologjik për pritjen dhe mundësinë që ata iu ofruan gjatë vizitës për t'u njohur nga afër me trashëgimin historike të këtij muzeu. Në fund të vizitës, të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi në mes dy institucioneve të vazhdojë edhe në të ardhmen, në funksion të mbrojtjes së trashëgimisë kulturo-historike të kësaj treve.



FSK-ja shënoi Ditën e Forcës me ceremoni ushtarake

Homazhe në Prekaz: Manifestimi i "Ditës së Forcës", 27 Nëntori, filloi me homazhe në "Kompleksin Memorial" në Prekaz. Ministri Agim Çeku, ishte pjesë e delegacionit të Qeverisë së Kosovës të prirë nga kryeministri Hashim Thaçi, ndërsa delegacioni i FSK-së udhëhoq nga komandanti i saj, gjeneraljtënant Kadri Kastrati. Të dy delegacionet vendosen kurora

me lule dhe bënë homazhe në varin e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe në varrezat e Jasharajve. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, me një manifestim solemn të mbajtur në kazermin "Adem Jashari" në Prishtinë, shënoi Ditën e Forcës, ditën e themelimit të saj dhe përuroi ndërtesën e re

të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ceremonia për shënimin e Ditës së Forcës filloi me inspektimin e kuadratëve të rreshtuara të FSK-së nga presidentja Atifete Jahjaga dhe gjeneraljtënant Kadri Kastrati. Ndërsa, në shenjë nderimi për të gjithë të rënë për Lirinë e Kosovës u mbajt një minutë heshtje.



Për të arriturat e FSK-së, foli komandanti i FSK-së, gjeneraljtënant Kadri Kastrati.

FSK-ja forcë moderne, profesionale dhe gatshme për detyra të reja

Forca e Sigurisë së Kosovës po e feston përvjetorin e saj të gjashtë. Është viti i gjashtë që në "Ditën e Forcës" takohemi këtu në kazermin „Adem Jashari“, në këtë kazerim që simbolizon shumëçka nga historia e lavdishme e Kosovës. Kjo ditë tashmë tradicionale na bashkon të gjithëve për të festuar dhe reflektuar njëkohësisht. Forca jonë, në themelet e saj ka të skalitur lavdinë dhe përvjetorin e trashëguar brez pas brezi. FSK-ja si forcë profesionale, shumënike dhe e motivuar, është institucioni më i besueshëm i vendit. Ky fakt na gëzon e na bënë krenarë, e njëkohësisht na obligon edhe më tepër, për të punuar fortë në ruajtjen e imazhit dhe besueshmërisë. Sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat kemi kaluar dhe ato që na presin, janë sprovat që do të kalohen falë vullnetit dhe përkushtimit tonë të fortë. FSK-ja ka shënuar përparim të vazhdueshëm në shumë fusha, një fakt ky që na bënë krenar. Kjo ditë e veçantë është një moment shumë i përshtatshëm për të shprehur mirënjohjen me të singertë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, të cilët po bartin në supet e tyre peshën e ngritjes dhe zhvillimit të FSK-së, në një Forcë moderne dhe profesionale



shpëtimin në ujëra, male dhe zona urbane, siç ishte operacioni në liqenin e Ujmanit, Reagimi i Shpejtë i bashkërenduar me institucionet tjera në rast të krizave, siç ishte reagimi i në termocentralin „KOSOVA“, Projektet humanitare, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës së qytetarëve, Asistenca mjekësore nëpër zonat e thella rurale. Këtë vit, Forca e Sigurisë së Kosovës ka marrë pjesë në një varg të ushtrimeve fushore dhe kurseve trajnuese. Duke punuar krah për krah me ushtarët nga shtetet e rajonit, pjesëtarët e FSK-së kanë dëshmuar që FSK-ja është forcë për të mirë dhe e gatshme të kontribuojë në sigurinë rajonale dhe globale. Në zhvillimin tonë të mëtejshëm, ne bashkëpunojmë ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë të cilëve ju jemi mirënjohës për mbështetjen e tyre. Posaçërisht, e falënderojmë NATO-në për mbështetjen e vazhdueshme. Ndihemi të bekuar për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Gardën Kombëtare të Ajovës. Me përmbylljen e procesit - Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë është kolauduar që Forca e Sigurisë së Kosovës të transformohet në Forcë mbrojtëse të vendit. Unë si komandant i FSK-së, me siguri të plotë mund ta ritheksoj që Forca e Sigurisë së Kosovës është e gatshme të transformohet në Forcë e Armatosura të Kosovës

dhe të merr DETYRAT E REJA - mbrojtjen e vendit dhe qytetarëve të saj. Kjo është një detyrë shumë fisnike dhe jemi plotësisht të përkushtuar ndaj saj.

Të nderuar të pranishëm,
Në këtë ditë të rëndësishme, solemnisht ua uroj Ditën e Forcës, të gjithë efektivat të FSK-së, të gjithë ushtarëve aktiv dhe rezervë, nënofficerëve dhe oficerëve të FSK-së. Urime Ditën e Forcës gjeneralë dhe oficerë, ju që me profesionalizmin më të lartë po komandoni dhe drejtoni, po planifikoni dhe po përcillni realizimin e çdo detyre. Urime Ditën e Forcës ju nënofficerë, që me vetëmohim dhe vetë-iniciativë po bëni që çdo detyrë e dhënë të realizohet suksesshëm. Shumë urime të nderuar dhe të respektuar ushtarë të FSK-së, që me vetëbesim, vetëmohim, guxim e besnikëri, të gatshëm dhe me profesionalizëm po i shërbeni vendit tonë me nderë. Uroj dhe fuqishëm besoj se përvjetori i ardhshëm i FSK-së do ta gjej Forcën tonë edhe më të përgatitur, duke marrë mbi vete detyra dhe përgjegjësi të reja në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit. Urime Ditën e Forcës të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, ju që pandërprerë po përkrahni Forcën tonë me besim.

Urime të gjithëve dhe ju falemindërit!



Nga fjala e presidentës së Kosovës, Atifete Jahjaga

Në rrugëtimin e saj FSK-ja ka pasur mbështetjen e NATO-s

Fjalën kryesore e mbajti Presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, e cila fillimisht uroi FSK-në për ditën e saj: "Dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për ju, gjeneralë e udhëheqës të FSK-së. Forca e Sigurisë së Kosovës është e ndërtuar mbi themele të fuqishme, që udhëhiqet nga synimi për të krijuar infrastrukturë të plotë të sigurisë në përpunje me nevojat e shtetit tonë dhe në harmoni me interesat tona kombëtare për të qenë faktor paqëje dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë. Në rrugëtimin e saj, FSK-ja ka pasur mbështetjen e NATO-s dhe forcës së saj paqeruajtëse në Kosovë, si dhe të Gardës



Kombëtare Amerikane. Me përmbylljen e procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë - një proces gjithëpërfshirës dhe ndërinstitucional - që analizozi mekanizmat tonë të sigurisë, nevojat e qytetarëve të Kosovës dhe interesat e orientimit strategjike të shtetit tonë - është shtruar nevoja e krijimit të një Force moderne të

armatosur, me kapacitete mbrojtëse, që adreson sfidat e sigurisë, e kompletion infrastrukturën tonë të sigurisë dhe në proces e sipër të profesionalizimit me standarde të NATO-s, synon anëtarësimin e saj të plotë në këtë aleancë. E ardhmja e Forcës së Armatosur të Kosovës, që nuk ka alternativë, mbetet punë parësore për Kuvendin e ri, institucionin kaq të nevojshëm dhe kaq të rëndësishëm për vendin dhe për qytetarët e tij, duke e bërë Kosovën me forcën e vet mbrojtëse, që do të komplettojë konsolidimin e shtetit tonë dhe do të bëhet kontribuuese e sigurisë kolektive të Evropës.

Nga fjala e kryeministrit të Kosovës

Transformimi i FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës ndër prioritetet e para

Ndërsa, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të pranishmit i përshëndeti kryeministri i saj, z. Hashim Thaçi, i cili, ndër të tjera, tha: "Më 21 janar mbushen 6 vjet që nga themelimi i njërit prej institucioneve më të rëndësishme dhe më prestigjioze të Republikës së Kosovës, Forcës së Sigurisë së Kosovës. Njëra ndër prioritetet e institucioneve që do të funksionalizohen së shpejti është edhe zotimi për ti kaluar të gjitha procedurat juridike që FSK-ja të transformohet sa më shpejt në Forcë të Armatosura të Kosovës. Jemi krenarë që FSK-ja, si institucion prestigjioz dhe profesional, sot funksionon në kapacitete të plota, e gatshme dhe e aftë për



të përmbyllur misionin e saj. FSK-ja, duke bashkëpunuar ngushtë me NATO-n dhe KFOR-in, sot është e gatshme që të kryejë të gjitha obligimet brenda në Kosovë, por edhe ato në rang të marrëveshjeve rajonale dhe shtetet përreth nesh. Të arriturat e FSK-së janë rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë dhe të frytshëm me Gardën Nacionale të Ajovës të SHBA-ve, me Ministrinë Mbrojtjes të shteteve

Amerikës, Britanisë së Madhe, Kroacisë, Turqisë dhe vendeve tjera. Edhe me këtë rast këtyre shteteve u shprehim dhe i falënderojmë për ndihmën dhe përkrahjen e tyre. FSK-ja është pjesë e iniciativave rajonale dhe përpjekjeve që të jetë e barabartë me shtetet anëtare të Kartës së Adriatikut. Ai, në fund, shtoi se: Perspektiva euroatlantike e FSK-së, do të jetë prioritet i qeverisë së re.

Medalje dhe dekorata për më të dalluarit për nder të Ditës së Forcës

Në fund të ceremonisë, për arritje të jashtëzakonshme u dekoruan ushtarë, nënofficerë dhe oficerë të FSK-së. Ministri dhe komandanti i FSK-së, me rastin e shënimit të "Ditës së Forcës", më 27 Nëntor 2014, me motivacionin për arritje të jashtëzakonshme ndanë medalje dhe dekorata për pjesëtarët e dalluar të Ministrisë dhe FSK-së: **Medalja "Shërbim i shquar"**, u jepet 21 pjesëtarëve të dalluar për shërbime të shquara në detyra me përgjegjësi të lartë, si dhe për realizimin e detyrave specifike dhe kontributin e shquar në reformimin, rristrukturimin dhe modernizimin e FSK-së. **Medalja "Arritje e jashtëzakonshme"**, u ndahet 16 pjesëtarëve të FSK-së për arritje të jashtëzakonshme në zbatimin e detyrave, të gatishmërisë, stërvitjes, disiplinës dhe marrëdhënieve në aktivitetet brenda dhe jashtë reparit. **Mirënjohja "Për angazhim dhe punë të dalluar"** u ndahet 15 pjesëtarëve të FSK-së. Medalja "Rezultate të larta në përvetësimin e

programit mësimor", gjatë shkollimit në Kolegjin e Luftës në Turqi, i ndahet një pjesëtarë të FSK-së. **Medalja "Shërbim vetëmohues"**, u ndahet 16 pjesëtarëve të MFSK-së dhe FSK-së me motivacionin performancë e dalluar gjatë kryerjes së detyrave. **Medalja "Komandant"**, me motivacionin për kryerjen me sukses të detyrës së komandantit të Kompanisë dhe performancës së shkëlqyeshme gjatë shërbimit u ndahet 2 pjesëtarëve të FSK-së.

Medalja "Rezultate të larta në përvetësimin e

Koloneli amerikan Chad Butts ligjëroi para oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së

Atasheu amerikan i Mbrojtjes kolonel Chad Butts i akredituar në Prishtinë, më 17 nëntor 2014, në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, për oficerët dhe nënoficerët mbajti një ligjëratë, për përvojën e tij gjatë karrierës ushtarake si pjesëtar i Forcave

Ushtarake Ajrore të SHBA-ve, me shërbim në Honduras, Gjermani dhe në Turqi.

Ai kryesisht u ndal te procedurat standarde operative, respektimi i tyre, ndjeshmëria dhe pritjet, ishin këto disa nga temat në të cilat u fokusua koloneli Butts. Ligjëratata ishte interaktive, ndërsa pjesëtarët e

KDS-së i parashtuan pyetje të shumta si dhe dhanë komentet e tyre.

Koloneli Butts u prit nga shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Fadil Hadërgjonaj i cili e falënderoi për kontributin e tij dhe përmes tij, ambasadën amerikane që po e ndihmon në vazhdimësi FSK-në.



FSK-ja ndërtoi rrugën në fshatin Bozhec të Ranillugut

Në fshatin Bozhec të Komunës së Ranillugut, më 07 nëntor 2014, u bë përfundimi i rrugës në gjatësi prej 2.5 km të ndërtuar nga Batalioni i Xhenios i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK)

Në këtë ceremoni morën pjesë: ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, eprorë të FSK-së, përfaqësues të komunës, banorë të fshatit dhe përfaqësues të KFOR-it suedez.

Me këtë rast, ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, fillimisht i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së për punën që kanë bërë, për angazhimin dhe vullnetin e treguar gjatë këtij projekti. "Kjo rrugë ka një domethënie të madhe, ku dëshmon se FSK-ja po iu shërben të gjitha komuniteteve, të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kjo është një dëshmi se këta qytetarë kanë pasur kushte të vështira, ndërsa tani kanë kushte shumë më të mira, dhe është ndjenjë shumë e mirë për ushtarët të cilët janë në shërbim të vendit, kur kryejnë një punë të mirë dhe të gjithë të falënderojnë, duke pas parasysh se esenca e punës sonë është shërbimi pa dallim për të gjithë qytetarët e të gjitha bashkësive". Në emër të komunës foli drejtori i Shërbimeve Publike, Ivan Janiajevic, i cili falënderoi Forcën e Sigurisë të Kosovës për



punën e bërë, e në veçanti falënderoi pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të cilët punuan në këtë projekt. Ai më pastaj tha se ka qenë një bashkëpunim shumë i mirë i FSK-së me autoritetet e komunës dhe banorët e fshatit.

Ndërsa, shefi i Shtabit të Batalionit të Xhenios, major Ilmi Ramusholli, i informoi të pranishmit për punën e pjesëtarëve të Batalionit të Xhenios në realiz-

imin e këtij projekti, rregullimin e rrugës së fshatit Bozhec. "Qëllimi i realizimit të këtij projekti ishte krijimi i kushteve sa më të mira për qarkullim i banorëve të këtij fshatit. Ky projekt ka filluar me 20 tetor dhe ka përfunduar më 07 nëntor 2014. Gjatë realizimit të këtij projekti është bërë hapja e kanalit anësor, nivelizimi, shtrirja e zhavorrit dhe trasimi i rrugës.

Batalioni i Parë i BRSH-së realizoi ushtrimin fushor "Shqiponja 3"

Batalioni i Parë i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Gjilan, realizoi ushtrimin fushor të koduar me emrin "Shqiponja 3". Ky ushtrim është realizuar në bazë të planit vjetor të aktiviteteve dhe trajnimeve në BRSH. Qëllimi i mbajtjes së ushtrimit fushor ishte testimi i gatishmërisë operationale të një-sive të BRSH-së. Sipas skenarit, nga pjesëtarët e Batalionit të Parë të BRSH-së, kërkohet ngritja e gatishmërisë në nivelin e tretë, që të jetë e gatshme që sipas urdhrat të operojë në zonën e operationit, për të kryer operatione të sigurisë dhe shpëtimin e jetës. Në ushtrimin e mbajtur kryesisht në terrenet e fshatit Zhegoc, morën pjesë 288 pjesëtarë. Personeli i Kompanisë 1 C realizoi me sukses këto detyra si vëzhgimin dhe lëvizjen e trupave natën, ngritjen e post komandës, komunikim në pika të vdekura, infiltrim të personelit në radhët e armikut (opozitës), vij rrethim dhe kërkim, pastrim të objekteve, komunikim me autoritetet lokale dhe testim i përgatitjes fizike. Ushtrimin fushor të Batalionit të Parë e vizitoi edhe shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore kolonel Naim Haziri, të cilin për rrjedhën e ushtrimit në terren e njoftoi komandanti i Batalionit të Parë nënkolonel Haki Xhemajli. Ndërsa kolonel Haziri i përgëzoi pjesëtarët e Batalionit të Parë të BRSH-së, për angazhimin, motivimin dhe profesionalizimin e treguar dhe njëherësh kërkoi vazhdimin e aktiviteteve me trajnime specifike në të gjitha fushat e mundshme. Ushtrimi fushor i koduar me emrin "Shqiponja 3" përfundoi me sukses.



Brigada për Reagim të Shpejtë testoi gatishmërinë operationale të një-sive të saj në terren

Brigada për Reagim të Shpejtë, në kuadër të planit vjetor të ushtrimeve dhe aktiviteteve të Komandës së Forcave Tokësore, më 10-11 dhe 12 nëntor 2014, bëri testimin e gatishmërisë operationale të një-sive të saj në terren. Trajnimi kishte për qëllim testimin e gatishmërisë së këtyre një-sive, në kryerjen e detyrave në kuadër të misionit të tyre, në ofrimin e mbështetjes autoriteteve të sigurisë dhe krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët. Komandën dhe Batalionin e Dytë të BRSH-së, gjatë ushtrimit, i vizituan: ministri i MFSK-së, z. Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, të cilët për aktivitetet e BRSH-së, i njoftoi komandanti i saj, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, ndërsa majori Ejup Maqedonci, ushtrues i detyrës të shefit të Shtabit të BRSH-së, bëri një prezantimin të detajuar për skenarin dhe operationet e një-sive të BRSH-së në terren. Përveç testimit të personelit të BRSH-së për proceset e planifikimit, prioritetet i saj ishte edhe testimi i një-sive operationale; operimi në terren me trupa. Testimi i një-sive të



BRSH-së, sipas skenarit, u realizua në dy lokacione, në Bjeshkët e Thata (Veri-Përdim të Kosovës) dhe në Zhegoc (Jug-Lindje të Kosovës). Në fund, ministri Çeku, gjeneral Kastrati, gjeneral Rama dhe stafi i

lartë i FSK-së, përcollën nga afër ushtrimet e një-sive të Batalionit 2-të, të mbajtura në "Bjeshkët e Thata" të Istogut, të cilët vlerësuan lartë ushtrimin dhe profesionalizimin e treguar të një-sive të BRSH-së në terren.

Major Genc Shala zëvendëskomandant i Kompanisë së Mjekësisë së FSK-së

Pjesëtarët e Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së me nivel të lartë profesionalizmi

Genc Shala është oficer i Kompanisë së Mjekësisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së) që nga viti 2009. Ai ka qenë edhe pjesëtar i TMK-së. Ai është specialist i mjekësisë interne. Studimet i ka përfunduar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Shenjat e para të dëshirës së tij për tu bërë mjekë dhe për t'i kuruar njerëzit ishin që nga shkolla e mesme. Ai thotë që lënda e biologjisë e veçanërisht gjenetika e kishin bërë që të thellohej më shumë në studime për të kuptuar se si funksionon trupi i njeriut dhe kjo e kishte mahnitë atë tej mase. "Ti shohësh njerëzit si janë duke u shëruar për çdo ditë nga sëmundjet është më të vërtet ndjenjë shumë e mirë, dhe kur e kupton që ti je personi që u ke ndihmuar në aspektin profesional, por edhe psikologjik. Çdo herë pjesëtarët e FSK-së si dhe familjarët e mi me pyesin në aspektin profesional për shqetësimet e tyre". Përveç punës që e bënë në FSK, major Shala është aktiv edhe atëherë kur e thërrasin në raste emergjente dhe në intervenime të ndryshme në spital, madje ai tregon se ka pasur raste edhe në orët e vona kur ka intervenuar, sepse FSK-ja e ka edhe gatishmërinë 24 orë. I pyetur se cilat janë detyrat e tij si zëvendëskomandant i kompanisë së mjekësisë ai ndër të tjera përmendi planet e punës, trajnimet, dhe shumë aktivitete të përditshme, por edhe angazhimin e tyre në raste krizash. Kompania e Mjekësisë ka ekipin e mjekimit (trajnimin), ekipin e farmacisë, tri ekipe të evakuimit, ekipin e stomatologjisë, si dhe ekipin e IT-së. Kjo kompani është përgjegjëse për trajtimin e të gjithë pjesëtarëve që gjenden në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Po ashtu pjesëtarët e kësaj kompanie janë përgjegjës edhe në transferimin e pjesëtarëve në spitalin ushtarak të Tiranës. Genc Shala tregon që pjesëtarët e Kompanisë së Mjekësisë janë shumë të përgatitur profesionalisht



dhe kanë një disiplinë pikërisht ashtu siç i duhet ushtarakut. Ai këtë profesionalizëm e mbështet me fakte që gjatë ushtrimeve fushore të përbashkëta të mbajtura në Maqedoni dhe në Slloveni, pjesëtarët e FSK-së kishin treguar nivelin e njëjtë me ushtritë e rajonit, por edhe më gjerë. "Nga trajnimet që i kemi bërë dhe situatat me të cilat jemi përballur, konsideroj se jemi në nivel të njëjtë profesional me vendet e rajonit dhe vendet tjera". Përveç angazhimeve ditore, Genci përmend edhe trajnimet dhe ligjëratat e ndryshme që mbahen nga pjesëtarët e tij. Ai përmendi ligjëratën me personelin shën-

detësor të Spitalit Rajonal të Prizrenit, për MASCAL (situatat me shumë lëndime). Rëndësi të veçantë po ashtu i kushtojnë edhe trajnimin për Ndihmën e Parë dhe certifikimi i pjesëtarëve pas përfundimit të këtij trajnimi dhe marrja e titullit si "Paramedik". Pastaj trajnimin e njëjtë që infermierët e Kosovës e kanë mbajtur në Kompaninë e Mjekësisë etj. Kemi shumë pjesëtarë jashtë vendit si: Gjermani, Turqi, Holandë, Shqipëri, Angli, SHBA, Maqedoni. "Nga Gjermania tanimë do kthehen dy pjesëtarë të cilët për dy vjet e kanë përfunduar shkollimin për teknik mjekësor, kurse në vendet tjera krye-

jinë shkollime kryesisht të fushës së mjekësisë por të fushave të ndryshme". Oficeri i lartë i FSK-së, major Genc Shala ka marrë pjesë edhe në trajnime në fushëbetejë: në Maqedoni "Shared Resilience", ku ka qenë edhe komandant i kontingjentit për FSK-në, dhe në Slloveni "Përgjigjeje e menjëhershme", si komandant i ekipit mjekësor dhe nga dy trajnime pjesëtarët e FSK-së kishin treguar rezultate shumë të mira profesionale dhe ushtarake. Ai ka të kryera edhe trajnime individuale si: Ndihma e parë, niveli I, në KDS, dhe niveli II, në Kompaninë e Mjekësisë, Ferizaj; Kursi Bazik moduli A(B); Shpëtimi i jetës në traumat e fushëbetejës, në Holandë; Sëmundjet infektive dhe tropikale, në Holandë, kursi për oficer, në KDS; seminar "Menaxhimi i katastrofave", në Prishtinë; trajnimin për instruktor të mjekësisë, në Bondesteel nga instruktorët e USA. Profesionalizmin individual dhe grupor major Shala e tregon edhe me intervenimet e shumta të pjesëtarëve të tij, sidomos, në vërshimet në Shqipëri gjatë viteve 2010-2011, intervenimin në Restelice, ku pjesëtarët e kishin nxjerr të gjallë një vajzë 5 vjeçare "Më pëlqen rregulli, disiplina dhe puna me përkushtim që e bëjnë të gjithë ushtarakët, "P.sh ka qenë rasti i Restelicës kur rreziku për të rënë

edhe një ortek tjetër ishte ende. Asnjë nga pjesëtarët nuk ishin tërhequr nga vendi i ngjarjes, sepse ata dëshironin që të ndihmonin në shpëtimin e jetës së njerëzve atje, kjo më bënë që si pjesëtar i FSK-së të ndjehem krenar dhe i privilegjuar që jam pjesë e një ekipi të tillë. I dua shumë ushtarët e mi dhe ata çdoherë janë të gatshëm për çdo situatë dhe detyrë që iu delegohet". Intervenimin e fundit në termocentralin Kosova A, ku po ashtu edhe në këtë operacion u nxjerr një djalë i gjallë, ishte gjithashtu dëshmi e suksesit të pjesëtarëve të FSK-së, e po ashtu edhe ekipit mjekësor. Në pyetjen se cili ka qenë momenti më i veçantë gjatë punës së tij si mjek në FSK, major Shala më shumë emocion përmend rastin kur pjesëtarët e Kërkim Shpëtimin e kishin nxjerr të gjallë vajzën 5 vjeçare Amsera Reka, i cili më pas e kishte dërguar në spitalin e Prizrenit. "Ndjenja më e mirë në jetën time ka qenë kur ma dhanë Amserën për ta dërguar në spitalin e Prizrenit dhe ngrohtësia që ndjeva ishte, edhe ajo që i kishte mbijetuar një fatkeqësie aq të madhe". Përveç punës si mjek në FSK ai kohen e lirë e shfrytëzon me aktivitete sportive, kujdesin për djalin e tij, një vjeç dhe duke e ndihmuar vajzën 8 vjeçare në mësimet dhe zgjedhjen e detyrave të ndryshme.



Kadetë të Akademisë Ushtarake të Turqisë vizituan FSK-në



Në bazë të Planit Implementues në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, më 10 nëntor 2014, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës qëndroi një delegacion i kadetëve (viti i katërt) të Akademisë Ushtarake Tokësore të Turqisë. Delegacioni i kadetëve të Turqisë u prit në MFSK nga i drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, kolonel Ilir Qeriqi me bashkëpunëtorë. Së bashku me kadetët ishte edhe

atasheu ushtarak i Turqisë në Prishtinë, kolonel Hasan Aydoglu dhe këshilltari i komandantit të FSK-së, kolonel Gultekin Yarali. Me këtë rast, gjeneral brigade Zymer Halimi i njoftoi kadetët me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për misionin, strukturën, bashkëpunimin regjional, SHBA-të, Gardën Kombëtare të Ajovës, NATO-n dhe në veçanti për bashkëpunimin me Turqinë. Kadetët e Akademisë Ushtarake të Turqisë gjatë takimit shprehën interesimin e tyre për të ardhmen e FSK-së, për krijimin e Forcave Ajrore, për Gardën Kombëtare dhe për Forcat Tokësore.



Certifikohen 38 pjesëtarë në kursin bazik të nënoficerit

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçes (KDS) në Ferizaj, më 24 nëntor 2014, u mbajt ceremonia e certifikimit të 38 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët për pesë javë rresht përfunduan me sukses kursin bazik të nënoficerit. Gjatë kësaj kohe ushtarët demonstruan shumë skenarë të ndryshëm të përgatitjes nga instruktorët e Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve (QZHPU), çka e bëri kursin shumë sfidues por edhe tërheqës, për shkak se brenda për brenda ushtarët ishin të organizuar në ekipe dhe ato ekipe garonin se cili prej tyre do të arrijë rezultate më të mira gjatë ushtrimeve teorike dhe praktike. Komandanti

i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaçi, në ceremoninë e certifikimit tha: "Mburremi me rezultatet tuaja për një sukses të përbashkët, duke ditur se kjo është gjenerata e dytë për këtë vit. Unë uroj që ju të angazhoheni në detyrat tuaja praktike, që të jeni shumë aktiv dhe të ndihmoni kolegët tuaj nëpër njësitë tuaja, ngase kjo është edhe një përvojë e re për ju dhe një ndihmë më shumë për njësitë tuaja". Ai në fund, shtoi: "Ky është kursi i parë që kryen një ushtar i FSK-së për t'u avancuar në gradë dhe fillim i avancimit në karrierë, dhe, kjo nuk duhet parë si privilegj por si një përgjegjësi shtesë drejt bërjes së karrierës".

FSK-ja realizoi marshin kondicional

Komanda e Doktrinës dhe Stërviçes në Ferizaj dhe Batalioni i Dytë i Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, më 17 nëntor 2014, realizuan marshimin kondicional. Ky aktivitet është realizuar në bazë të planit vjetor të trajnimeve të KDS-së dhe Batalionit të Dytë të BRSH-së. Qëllimi i marshimit ishte testimi dhe mbajtja e kondicionit fizik të pjesëtarëve të FSK-së në distanca të gjata. Komanda e Doktrinës dhe Stërviçes në Ferizaj, më 07 nëntor 2014, realizoi marshimin kondicional të koduar me emrin "Vjeshta 2014". Në këtë marshim kanë marrë pjesë 123 pjesëtarë të KDS-së si dhe 38 kadetë nga Kursi Bazik, ndërsa personeli ka qenë me pajisje per-

sonale duke përfshirë edhe armët e gjata. Marshimi u realizua në rajonin e Ferizajt dhe të Suharekës. Edhe Batalioni i Dytë i BRSH-së marshimin e ka realizuar më 07 nëntor 2014 në lokacionin e Istogut. Të gjithë pjesëtarët pjesëmarrës e kanë përfunduar marshimin me sukses. Ky fakt dëshmon se pjesëtarët e këtij batalioni posedojnë përgatitje të lartë fizike dhe janë të gatshëm të përballojnë çfarëdo detyre dhe sfide. Në këtë marshim kanë marrë pjesë 142 pjesëtarë nga katër kompani të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, përfshirë këtu edhe stafin komandues në krye me komandantin e saj, nënkolonel Mehmet Lladrovcin.



SPORT

FSK-ja për nder të Ditës së Forcës organizoi gara sportive

Në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, me rastin e shënimit të Ditës së Forcës, FSK-ja organizoi gara sportive në disa disiplina si në futboll, atletikë, shah dhe çitje me armë.

Garat u organizuan për dy javë rresht me aktivitete të ndryshme sportive. Pjesëmarrësit në këto gara treguan përgatitje të lartë fizike dhe efikasitet të shkëlqyeshëm në çdo disiplinë.

Më 21 nëntor 2014 u zhvillua ndeshja finale ndërmjet dy ekipeve të Brigadës për Reagim të Shpejtë, atij të Batalionit të Parë dhe Batalionit të Tretë, ku fitues doli ekipi i Batalionit të Parë. Garat finale, nga afër, i përcolën zëvendëskomandanti i FSK-së njëherësh komandant i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, komandant i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Enver Cikaçi, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçes (KDS), shef i shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri si dhe



ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe të NLAT-it. Ekipet fituese sipas disiplinave u shpallën si në vijim: Në disiplinën e shahut, vendin e parë e zuri Ferid Zhdrella -rreshter në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçes, vendin e dytë Feim Qorrolli -rreshter në KDS dhe në vendin e tretë u rendit rreshter Hilmi Zenun. Në çitje me armë, vendi i parë i takoi

Razim Berishës-kapter në KDS, vendi i dytë Afrim Musliut -tetar në Komandën e Forcave Tokësore dhe vendi i tretë Blerim Bytyçit -rreshter në Brigadën e Mbështetjes Operacionale. Në garat e atletikës, në konkurrencën e femrave vendin e parë e zuri Liridonë Musaj- ushtare në Regjimentin e Mbrojtjes Civile, vendin e dytë Adelina Gashani-tetare



në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçes dhe vendi i tretë i takoi Hidajete Hoxhës -ushtare në Regjimentin e Mbrojtjes Civile. Ndërsa në konkurrencën e meshkujve vendin e parë e zuri Migjen Shalau-shtar në Regjimentin e Mbrojtjes Civile, vendin e dytë Besnik Nebihu po ashtu ushtar në Regjimentin e Mbrojtjes Civile dhe në vendin e tretë u rendit Arben Vicishiqi - ushtar në

Batalionin e Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë.

Në futboll, vendin e parë e zuri ekipi i Batalionit të Parë të BRSH-së, të dytin ai i Batalionit të Tretë të BRSH dhe vendin e tretë ekipi i Batalionit të Xhenios.

Organizimi i garave për nder të "Ditës së Forcës" tashmë është bërë traditë në FSK, ndërsa këto aktivitete çdo vit e më tepër po shkojnë duke u avancuar si në aspektin e organizimit, po ashtu edhe në atë të pjesëmarrjes kualitative dhe të konkurrencës ndërmjet ekipeve.

Në emër të FSK-së, zëvendës komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, i përgëzoi pjesëmarrësit dhe organizatorët e këtyre garave. Në fund, ekipet fituese dhe garuesit më të mirë u nderuan me medalje, kupa dhe mirënjohje, nga gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Enver Cikaçi, kolonel Naim Haziri dhe oficerë të NLAT-it.

